



Prishtinë, 16 mars 2017
Kodi i ZRRE-së: V_899_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 par 1 dhe nenin 14 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 paragrafi 9, 10 dhe 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-810-2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lokacionin HC "Kaqandoll", ZK Segace-Popovë, me kapacitet të instaluar prej 2.6 MW, në Komunën e Podujevës, të datës 30.01.2017 të shoqërisë "Hidrocom" Sh.p.k., me adresë: rruga "Richard Hollbrook" Veternik, Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

në seancën e mbajtur me datë 16 mars 2017 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI PRELIMINAR** shoqërisë "Hidrocom" Sh.p.k., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC "Kaqandoll", në lokacionin ZK Segace/Popovë, me kapacitet të instaluar prej 2.6 MW, në Komunën e Podujevës, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit "Hidrocom" Sh.p.k., do t'i lëshohet **AUTORIZIMI FINAL** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.

- IV. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcakton disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- V. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcakton se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- VI. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar lëshohet për periudhë një (1) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II. të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkojë lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.

Arsyetim

- o ZRRE me datë 30.01.2017 nga shoqëria "Hidrocom" Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapacitetit të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC "Kaqandoll", në Lokacionin ZK Segaqe/Popovë, me kapacitet të instaluar prej 2.6 MW, në Komunën e Podujevës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE me datë 27.02.2017 nga shoqëria "Hidrocom" Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse.
- o ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimit të dëshmive plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, ka konstatuar se shoqëria "Hidrocom" Sh.p.k. ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC "Kaqandoll", në Lokacionin ZK Segaqe/Popovë, me kapacitet të instaluar prej 2.6 MW, në Komunën e Podujevës. Gjithashtu ka vlerësuar edhe kërkesën për pranim në skemën mbështetëse, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Podujevës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:


Krenar Bujupi, U.D kryesues


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar